

Kryeministri i Turqisë dhe njëkohësisht Kryetari i AK Partisë, Ahmet Davuto?lu në mbledhjen e grupit parlamentar të kësaj partie ka drejtuar kritika të ashpra ndaj Perëndimit në lidhje me situatën në Siri, raporton Anadolu Agency (AA).

Davuto?lu në fjalimin e tij është shprehur se janë duke dëgjuar zëra kundërshtues që rebelojnë ndërgjegjen në lidhje me konfliktin e armatosur në Siri.

"Nëse ulesh dhe i shtrëngon dorën Asadit, ajo dorë e shtrënguar nuk do të fshihet kurrë nga kujtesa e ndërgjegjes njerëzore. Të shtrëngosh dorën e Asadit nuk ka ndonjë ndryshim me shtrëngimin e duarve të Hitlerit, Millosheviçit, Radovan Karaxhiçit apo Sadamit" është shprehur ai ndër të tjera.

Davuto?lu në vazhdim të fjalës së tij ka thënë se Turqia ia ka hapur dyert të gjithë refugjatëve të ardhur në kufijtë e tyre.

"Ne nuk kemi bërë asnjë dallim rrace apo meth'hebi. Kush do që erdhi në kufinjtë e Anadollit i kemi mirëpritur dhe Zoti është dëshmitar për këtë. Nuk kemi lënë askënd jashtë për shkak të mendimit, etnisë apo meth'hebit" është shprehur Kryeministri turk në fjalimin e tij përpara deputetëve të AK Partisë në mbledhjen e përjavshme të grupit të organizuar në Parlamentin e këtij vendi.